



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. 660/7 Prot.

Tiranë, më 30/12/2016

V E N D I M

Nr. 178, Datë 30/12/2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
“PROCEDURA DHE REZULTATET E MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE NË SHQIPËRI”

Në zbatim të planit vjetor 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSIAI etj.), sipas shkresës nr. 660/3 prot., datë 11.10.2016, Program Auditimi, ndërmoi auditimin me temë “Procedura dhe rezultatet e marrëveshjeve hidrokarbure në Shqipëri”.

Ky auditimi u programua për t’u ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI), Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Albpetrol Sha për procedurën dhe rezultatet e marrëveshjeve hidrokarbure, duke u fokusuar në ato në fazë zhvillimi dhe prodhimi me përqendrim në fushën naftë-mbajtëse më të pasur të Patos-Marinzës. MEI ka për detyrë, midis të tjerave, vënien nën një monitorim të plotë të veprimtarisë së hidrokarbureve për të patur një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të garantuar interesat publike, forcimin e kapaciteteve shkencore dhe teknike në funksion të zhvillimit të këtij sektori. AKBN është në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit përgjegjës për energjinë dhe shërben si organ i specializuar për promovimin e zonave të lira hidrokarbure, zhvillimin e aktivitetit të licencimit të kompanive që hyjnë në marrëveshje hidrokarbure, zbatimin e marrëveshjeve të lidhura në fushën hidrokarbure etj. Albpetrol-i është shoqëri publike që luan një rol të rëndësishëm në Marrëveshjet Hidrokarbure (MH) dhe Licencë-Marrëveshjet Hidrokarbure (LMH) që nga faza e negociimit deri në dhënien e saj, si dhe në monitorimin e gjithanshëm, inspektimin, vëzhgimin, raportimin, auditimin e tyre për të garantuar zbatimin e marrëveshjes sipas kërkesave të saj.

Sipas ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar, të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar. Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij, ka për kompetencë midis të tjerave auditimin, me qëllim mbrojtjen e interesave publikë, në veprimtaritë apo sektorët e rregulluar me kontrata koncesionare, objekt auditimi u bë sektori hidrokarbur, me fokus në marrëveshjet në fazë zhvillimi dhe prodhimi. Hidrokarburet janë një nga burimet më të rëndësishme energjetike të tokës, mbizotërues të të cilëve është të qenit një burim i djegshëm i karburantit, në përbërjen e naftës dhe gazit nëntokësor. Në kushtet kur në vendin tonë ka prirje të rritet kërkesa për konsumin e energjisë (në vitin 2014 është rritur 16% krahasuar me 2003), 67,7% e energjive të

prodhuara janë nga nafta; industria nxjerrëse (pra përfshirë dhe sektorin minerar) kontribuon rreth 5% në GDP dhe në buxhet (përfshirë dhe energjinë elektrike) grumbullohen prej tyre 3,5% e të ardhurave; sektori i transportit vazhdon të mbajë peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 40,43% etj., i bëjnë hidrokarburet një element të rëndësishëm për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm, rritjes ekonomike dhe punësimit. Veç këtyre veprimtaria e nxjerrjes së hidrokarbureve është e lidhur ngushtësisht me karakterin mjedisor të saj, duke ndikuar drejtpërdrejtë nivelin e mirëqenies së zonave naftëmbajtëse dhe më gjerë.

Gjithashtu, KLSH është e shqetësuar për mungesën e fitimit të shtetit shqiptar nga marrëveshja hidrokarbure në fazë prodhimi për fushën naftë-nxjerrëse të Patos-Marinzës. Kjo pasi, nga auditimet e rregullshme në AKBN dhe Albpetrol ShA gjatë 4-5 viteve të fundit, ka rezultuar se faktori R është më i vogël se 1 (Raporti i shpenzimeve të kryera me të ardhurat e realizuara nga shitja e naftës brut), duke shfaqur dhe pëformancën e dobët të veprimtarisë së tyre në këtë drejtim.

Gjithashtu, auditimi i jashtëm publik nëpërmjet KLSH, dhe për më tepër ai i performancës, është funksioni që lidh hallkat e ndryshme të aktiviteteve në institucione apo agjenci qeveritare, duke i orientuar ato drejt efektivitetit, eficiencës e economicitetit dhe, në kuadër të këtij auditimi, nxitjen e përmirësimeve tërësore të nevojshme, në funksion të arritjes së rezultateve të parashikuara nga hartimi dhe zbatimi i marrëveshjeve hidrokarbure.

Në përfundim të punës audituese në terren, iu dërgua Projekt-raporti i Auditimit subjektiv të audituar me shkresën nr. 660/4 prot., datë 24.11.2016. Pas respektimit të afatit njëmuor për observacione mbi Projekt-raportin nga subjektet e audituara, vetëm Sektori i promovimeve në Drejtorinë e Hidrokarbureve të AKBN me shkresën nr. 4773/3 prot., datë 22.12.2016, ka trajtuar çështje që i përkasin marrëveshjeve hidrokarbure në fazë kërkimi, ndërsa MEI dhe Albpetrol nuk kanë sjellë observacione.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

K O N K L U D O V A:

Shqipëria ka rezerva të konsiderueshme të naftës dhe gazit, të cilat kanë inkurajuar investitorët e huaj për të filluar kërkimin, zbulimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, si burime të papërsëritshme nëntokësore natyrore, nëpërmjet të cilave janë përfituar të ardhura të konsiderueshme në buxhet dhe në PBB.

Pas kolapsit ekonomik të viteve '90, u ndërmorën lëvizje ristrukturoese drejt privatizimit, si dhe u bënë përpjekje për afrimin e investitorëve të huaj, duke diktuar nevojën emergjente për ndryshime në fushën e legjislacionit, si një mjet rregullator për mënyrën e menaxhimit dhe të perspektivës së sektorit të hidrokarbureve. Në vitin 1993 u krijua hapësira ligjore për të bërë të mundur transferimin e veprimeve (prodhimin) nga shteti drejt investitorëve cilësor. Në këtë kuadër, politikat e zbatuara nga qeveritë shqiptare kanë synuar tërheqjen e investimeve të huaja, nëpërmjet krijimit të regjimeve të leverdishme ligjore dhe financiare për nxjerrjen e naftës dhe gazit.

Zhvillimi sektorit të naftës dhe gazit nëpërmjet marrëveshjeve hidrokarbure të kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit ka nisur që në vitin 1991, me nënshkrimin e 5 marrëveshje me kompani të huaja si: “D A P

G e O”, “HOA” etj. Aktualisht janë 11 marrëveshje me kompanitë që kryejnë operacione hidrokarbure: 5 Marrëveshje Hidrokarbure për prodhimin dhe zhvillimin e vendburimeve ekzistuese të naftës dhe gazit dhe 2 Marrëveshje Hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit në blloqet e kërkimit, të nënshkuara me Albpetrol ShA; si dhe 4 marrëveshje hidrokarbure për kërkim dhe prodhim në blloqet e kërkimit të lidhura me ministrinë përgjegjëse për hidrokarbure të tipit me ndarje prodhimi.

Nevoja për të hyrë në marrëveshje hidrokarbure e një vendi vjen kryesisht nga kufizimet e shtetërore (mungesa e kapitalit), rritja e shpejtë e kërkesës për karburante, luhatjet e çmimit të naftës (e lidhur kjo me mekanizmat e ndarjes së riskut) mungesa e teknologjisë, specializimi i kufizuar në këtë fushë etj. Marrëveshjet hidrokarbure kanë si qëllim të përcaktojnë si ndahet prodhimi i naftës midis zotëruesve të kapitalit (privat, publik ose të përzierë) dhe zotëruesit të burimeve natyrore (në këtë rast shtetit). Në se shteti synon zhvillimin e hidrokarbureve, inkurajimin e pjesëmarrjes së sektorit privat, duke i lënë një sasi prodhimi të mjaftueshëm, kontraktori ka për objektiv studimin nga pikëpamja e riskut të zbulimit, së bashku me kohën e nevojshme në dispozicion, si dhe të drejtën e shitjes të një pjese të konsiderueshme të prodhimit për mbulimin e kostove. Marrëveshjet me ndarje prodhimi janë kontrata sipas të cilave shteti është zotërues (pronar) i burimeve hidrokarbure, i jep një kompanie në cilësinë e kontraktorit të drejtën ekskluzive për zbulimin dhe zhvillimin e vendburimit nëpërmjet ofrimit të shërbimeve teknike dhe financiare.

Një nga marrëveshjet hidrokarbure më të rëndësishme për vendin tonë është ajo për vendburimin e Patos - Marinzës (njihet si një nga zonat naftëmbajtëse më të mëdha në Evropë), e cila është nënshkruar me datë 19.06.2004 dhe miratuar me VKM nr. 477, datë 16.07.2004. Sipas të dhënave për prodhimin e naftës në vitin 2015, 92% e naftës brut i përket kompanisë B P me të cilën është nënshkruar marrëveshja për këtë vendburim, duke u bërë kështu përcaktuese për zhvillimin e sektorit hidrokarbur në Shqipëri.

Sipas marrëveshjes me ndarje prodhimi të nënshkruar për këtë vendburim, shteti shqiptar vitet e para përfiton prodhimin paraekzistues për pusët e marrë në dorëzim nga Albpetrol ShA dhe 1% të prodhimit gjithsej. Bazuar në Planin e zhvillimit fillestar, në vitin 2009 dhe më pas në atë të ndryshuar në vitin 2011, kontraktori B P do të arrinte që me të ardhurat të mbulonte shpenzimet (kostot) hidrokarbure (pra $R > 1$), duke bërë të mundur që të përfitohej nga pala shqiptare 50% e fitimit si dhe 3% e prodhimit gjithsej. Në fakt edhe pas 12 viteve shfrytëzimit të vendburimit të Patos-Marinzës, kompania B P nuk ka arritur të dalë me fitim, duke i kufizuar përfitimet e shtetit shqiptar vetëm në 1% të prodhimit, në 10 % të rentës minerare, si dhe në zvogëlim të vazhdueshëm të prodhimit paraekzistues. Veç të tjerave, një ecuri e tillë e kësaj marrëveshje në lidhje me nivelin e ulët të përfitimit nga kjo zonë e pasur naftëmbajtëse, është pasojë dhe e performancës së ulët të institucioneve shtetërore MEI e AKBN, dhe Albpetrol ShA nëpërmjet shqyrtimit, analizimit dhe miratimit të planeve të zhvillimit, Programeve dhe Buxheteve vjetore, kryerjes së monitorimeve, inspektimeve, kontrolleve, supervizimeve, auditimeve etj.

KLSH analizoj ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje për një periudhë mbi 10 vjeçare, duke shqyrtuar performancën e enteve publike MEI e AKBN, si dhe të Albpetrol Sha si palë në këtë marrëveshje dhe licencë-marrëveshje. Një analizë e tillë është kryer duke marrë në konsideratë ligjin e posaçëm hidrokarbur dhe zbatimin e tij, strukturat organizative dhe rregulloret e brendshme të këtyre enteve në funksion të këtij sektori, të drejtat që u linden sipas marrëveshjes dhe licencë - marrëveshjes dhe ushtrimi i tyre i bazuar në dokumentacionin përkatës.

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes: *A janë siguruar përfitimet ekonomike dhe financiare sipas treguesve dhe afateve nga marrëveshjet hidrokarbure të prodhimit ?*, dhe në përfundim ka arritur në këtë mesazh auditimi:

Mungesa e një kuadri rregullator të përditësuar sipas modeleve më të mira bashkëkohore dhe mospërcaktimi i saktë dhe i qartë i të drejtave, detyrimeve dhe penalizimeve në marrëveshjet

hidrokarbure, si dhe performanca e dobët e veprimtarisë së institucioneve publike në këtë fushë, e shoqëruar me një mungesë bashkëpunimi dhe bashkërendimi të veprimtarisë ndërmjet tyre në lidhje me monitorimin, inspektimin, kontrollin dhe auditimin e zbatimit të këtyre marrëveshjeve, ka ndikuar negativisht në arritjen e përfitueshmërisë ekonomike dhe financiare të shtetit shqiptar, duke rrezikuar përdorimin racional të burimeve nëntokësore të naftës, si dhe duke kërcënuar mjedisin.

Nisur nga konkluzionet mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve në këtë sektor:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Procedura dhe rezultatet e marrëveshjeve hidrokarbure në Shqipëri”, të ushtruar në MEI, AKBN dhe Albpetrol Sha.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

I. Për pyetjen: A i ka shërbyer kuadri rregullator i hidrokarbureve rritjes së përfitimeve prej marrëveshjeve të prodhimit?

- Ligji nr. 7746 datë 28.07.1993 Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), megjithëse ka pësuar ndryshime 6 herë deri në periudhën aktuale, vazhdon të shfaqë probleme në lidhje me:

- Përkufizimin e Marrëveshjeve me Ndarje Prodhimi, si marrëveshje e cila parashikon mbulimin e plotë të kostove hidrokarbure, pa hapësira në një nivel të caktuar përqindjeje deri në mbulimin e plotë të tyre;
- Nuk është në përputhje me strategjinë e thithjen e investimeve dhe investitorëve të huaj me përvojë ndërkombëtare në fushën e hidrokarbureve, por e lë evazive për marrëveshje këtilla dhe për persona fizik dhe shoqata;
- Nuk është i qartë dhe konciz në lidhje me vendim-marrjen e ministrisë së linjës së energjisë për përcaktimin e investitorëve të fushës së hidrokarbureve, pasi nuk përcakton kritere por e lë mbi bazën e “bindjes”, si dhe krijon mundësinë e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve me investitor dhe pa kapacitetet e nevojshme financiare, por që mund t’i sigurojë ato gjatë zbatimit;
- Nuk ka përcaktime ligjore mbi nivelin kufi të nënkontraktimit të punëve, mallrave dhe/ose shërbimeve, pasi nënkontraktimet rrisin kostot hidrokarbure dhe për pasojë shtyjnë në kohë dhe zvogëlojnë përfitimet e shtetit nga pasuritë nëntokësore të veta;
- Nuk ka karakter detyrues për ministrinë në hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe kontratave model, mungesa e të cilëve ul ndjeshëm efektivitetin e kuadrit rregullator në përfitueshmërinë e shtetit shqiptar nga marrëveshjet hidrokarbure;
- Marrëveshjet hidrokarbure të prodhimit megjithëse zgjasin më shumë se një çerek shekulli dhe pretendohet të shpenzohen qindra miliona dollarë (ose euro), krahas problemeve të tjera, vazhdojnë të bëhen efektive me vendim të Këshillit të Ministrave, duke e mbyllur ciklin e tyre brenda qeverisë së radhës.

- Nuk ka përfunduar akoma rregullorja “Për aktivitetet e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri”, e cila do të mbështesë dhe sigurojë realizimin e rolit rregullator dhe kontrollues të shtetit nëpërmjet organeve, strukturave dhe institucioneve, për një përputhje të plotë me Direktivën 94/22/EC të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës.

Për sa më sipër rekomandojmë:

1. **MEI të marrë masat e nevojshme për të hartuar dhe propozuar një ligj të ri për Hidrokarburet, duke mbajtur në konsideratë konkluzionet e mësipërme, si dhe duke u konsultuar me entet publike që veprojnë në fushën e hidrokarbureve (AKBN dhe Albpetrol ShA) për të ezauruar problematikën e shfaqur deri tani nga zbatimi i tyre, si**

dhe për ta harmonizuar me sistemin legjislativ kombëtar dhe atë ndërkombëtar të fushës.

Brenda tremujorit të parë 2017

- 2. MEI të propozojë miratimin e marrëveshjeve të hidrokarbureve në Kuvendin e Shqipërisë, me qëllim sigurimin e një modeli dhe treguesve të tyre me mbështetje sa më të gjerë, si dhe të shmangë mbylljen e ciklit të vendim-marrjes brenda qeverisë, kjo për shkak dhe të kohëzgjatjes me periudha që kalojnë mandatin e një qeverie.*

Brenda tremujorit të parë 2017

- 3. MEI të marrë masat e nevojshme për të përfunduar rregulloren “Për aktivitetet e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri”, për të mbështetur dhe siguruar rolin rregullator dhe kontrollues të shtetit nëpërmjet organeve, strukturave dhe institucioneve, si dhe për një përputhje të plotë me Direktivën 94/22/EC.*

Brenda muajit janar 2017

II. Për pyetjen: A ka qenë efektive veprimtaria e MEI-t në sektorin e marrëveshjeve hidrokarbure?

- Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve në MEI nuk ka një trajtim prioritar të veprimtarisë së sektorit të nxjerrjes së naftës dhe gazit, për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit hidrokarbur dhe garantimin e interesave publike, pasi gjithçka mbi zhvillimin e marrëveshjeve hidrokarbure, MEI ja kalon AKBN-së dhe Albpetrol ShA.
- Marrëveshja hidrokarbure për Patos-Marinzë ka kaluar një dekadë nga negocimi, hartimi dhe miratimi, nuk është ndryshuar për t’ju përshtatur zhvillimeve të vendit dhe përmirësimit të harmonizuar të interesave për shtetin shqiptar.
- Kjo Marrëveshje është mjaft komplekse lidhur me kuadrin ligjor, pasi sipas saj, aktivitetet hidrokarbure administrohen dhe kryhen sipas ligjit shqiptar; interpretimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve subjekt arbitrimi sipas ligjeve të Anglisë; konfliktet, mosmarrëveshjet, pretendimet ose ndryshimet në opinion zgjidhen nga Arbitrazhi Ndërkombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, në Paris Francë, i cili do të zhvillohet në Zyrë, Zvicër.
- Ka mjaft përcaktime evazive në lidhje me zbatimin e kërkesave teknike dhe financiare dhe përdorimit të metodave, procedurave, teknologjive dhe pajisjeve përgjithësisht të pranuara në industrinë ndërkombëtare të naftës.
- Megjithëse Plani i zhvillimit në frymën e kësaj marrëveshje përcakton “shinat” nga dhe si duhet të ketë ecurinë e saj 25 vjeçare, nuk vë kusht përputhjen ose shkallën e mospërputhjes me Programet e punës dhe Buxhetet vjetore.
- Mbulimi i plotë i kostove hidrokarbure me të ardhurat nga nafta e disponueshme e bën këtë marrëveshje shumë të ndjeshme ndaj vitit në të cilin parashikohet, kuptohet me mbartje risku, që të rritet pjesa e Albpetrolit nga 1% në 3% si dhe ndarja e fitimit në raportin 50% me 50%. Në fakt kjo duhet parë dhe me kohën që një kompani qoftë kjo edhe ndërkombëtare mundet të ketë aktivitet me humbje. Kjo pasi në se B parashikonte në planin e zhvillimit fillestar në vitin 2009 $R > 1$ pastaj me ndryshimet e tij në vitin 2012 dhe aktualisht edhe pas 12 vitesh vazhdon të jetë me humbje ($R < 1$, pasi të ardhurat nuk mbulojnë kostot), është pa kuptim teorik dhe praktik, ekonomik dhe financiar.
- Guri i themelit në krijimin e kostove hidrokarbure të fryra nga ana e kontraktorit dhe pamundësia e shtetit shqiptar për mosnjohjen dhe zbritjen e tyre, është përcaktimi evaziv i tyre në marrëveshje: të gjitha shpenzimet e mbartura dhe të kryera nga Kontraktori në ose në lidhje me kryerjen e operacioneve hidrokarbure në përputhje me këtë marrëveshje.
- Konfidencialiteti mbi këtë marrëveshje në të gjitha përmasat e tij, jo vetëm që mbulon me mister veprimet e kontraktorit, por nuk është transparente para publikut për të njohur dhe për t’i bërë të ditur se si dhe sa po shfrytëzohen pasuritë kombëtare nëntokësore, duke rritur përgjegjësinë dhe llogaridhënien e qeverive përballë taksapaguesve.
- Nuk përcakton shkallën e nënkontraktimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve, jo vetëm kanë rritur kostot, por ndërkohë që ato marrin fitime të majme nga kryerja e këtyre shërbimeve apo investimeve, kontraktori vazhdon të jetë me humbje.

- Edhe për auditet mbi deklaratat e llogarisë kosto, Albpetroli nuk ka rol urdhërues por këshillues pa përcaktuar afate për procedura dhe dokumentacion të auditimit (projektraport, raport, afate etj.)
- Ka një dublim dhe paqartësi midis të drejtave që i linden Albpetrol ShA mbi bazën e marrëveshjes dhe AKBN mbi bazën e Licencë-Marrëveshjes dhe Marrëveshjes.
- KLSH vlerëson iniciativën e Këshillit të Ministrave dhe MEI-t për ringritjen e Institutit të Naftës dhe Gazit, i cili ka qenë një rekomandim i KLSH mbas auditimeve të thelluara në AKBN dhe Albpetrol Sha të periudhës 2013-2015.

Për sa më sipër rekomandojmë:

4. **MEI të rishikojë Rregulloren brendshme të funksionimit, me qëllim që Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve t'i vendosë detyra prioritare ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure të nxjerrjes së naftës dhe gazit, nëpërmjet bashkërendimit të veprimtarisë me AKBN dhe Albpetrol në terma real dhe me një periodicitet të caktuar.**

Brenda tremujorit të parë 2017

5. **MEI të përcaktojë me ligj, në mënyrë të qartë dhe të prerë për mundësinë e hyrjes në marrëveshje me kompani ndërkombëtare me përvojë në fushën hidrokarbureve, të cilët zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike, njerëzore dhe financiare për zbatimin e tyre, duke siguruar shfrytëzim eficient të pasurive nëntokësore natyrore.**

Brenda tremujorit të parë 2017

6. **MEI, në bashkëpunim me AKBN, Albpetrol dhe palë të interesit të hartojë draft-marrëveshjen hidrokarbure mbi të cilin negociohet, për të shmangur problematikat e deri tanishme si dhe qartësimi i rolit të Albpetrol dhe AKBN, për të harmonizuar më mirë interesat e investitorëve dhe shtetit shqiptar në shfrytëzimin e pasurive kombëtare natyrore.**

Brenda tremujorit të parë 2017

7. **Instituti i Naftës dhe Gazit sapo të ringrihet dhe të fillojë funksionimin e tij, të bëjë një analizë të hollësishme të situatës aktuale në Marrëveshjet Hidrokarbure në vendin tonë, nëpërmjet analizës së raporteve të KLSH, duke rekomanduar rrugët përkatëse për përmirësimin e gjendjes.**

Brenda tremujorit të parë 2017

III. Për pyetjen: A ka qenë efektiv aktiviteti i strukturave të AKBN në marrëveshjet hidrokarbure të prodhimit ?

- Të gjitha ndryshimet në numrin dhe strukturën organike të sektorit hidrokarbur (Drejtoria e hidrokarbureve dhe ajo e Procedurave hidrokarbure), konstatohen se nuk janë jenë rezultat i analizës së performancës së sektorëve dhe specialistëve brenda tyre, por të iniciuara nga jashtë, duke ulur ndjeshëm ndikimin e veprimtarisë tyre në sektorin nxjerrjes së naftës dhe gazit.

- Në periudhën 2006-2016 (që përfshin me atë të marrëveshjes hidrokarbure të Patos-Marinzës, të fokusuar në këtë auditim), Drejtoria e Hidrokarbureve ka pasur rreth 65 lëvizje, me goditjen më të madhe në vitin 2013 nga largimet e 13 specialistëve ose pothuajse i gjithë stafi i kësaj drejtorie, duke ndikuar ndjeshëm në një performancë të dobët në zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure në përgjithësi dhe atyre në fazë prodhimi në veçanti.

- Rregullorja e brendshme e AKBN nuk përfshin në organizim Drejtorinë e Procedurave Hidrokarbure, si dhe në përshkrimin e punës së Sektorit të promovimeve konstatohet të ketë, disa detyra të vështira për t'u realizuar nga ana e tij, siç mund të jetë ajo e hartimit dhe propozimit të politikave dhe strategjive të promovimit të hidrokarbureve etj., kjo me numër të barabartë punonjësish me dy sektorët kyç të Drejtorisë së hidrokarbureve, atë të licencave dhe atë të marrëveshjeve, për në tepër në AKBN ka një drejtori për marrëdhëniet me publikun në përbërje të të cilit janë 10 specialistë.

- Sektori i monitorimit të marrëveshjeve në Drejtorinë ekonomike, e ka të lidhur veprimtarinë me bashkëpunimin me Drejtorinë Hidrokarbure për kryerjen e auditimit tekniko financiar të Marrëveshjeve dhe Licencë Marrëveshjeve Hidrokarbure, duke evidentuar nevojën e mbylljes së ciklit të plotë të aktivitetit brenda Drejtorisë së hidrokarbureve.

- Megjithëse, AKBN ka një rol të konsiderueshëm në veprimtarinë hidrokarbure në Shqipëri, në përshkrimin e vendeve të punës nuk është përcaktuar bashkëpunimi, shkëmbimi i informacionit dhe koordinimi me kompaninë kombëtare të hidrokarbureve (Albpetrol SHA) në fushën e zbatimit të marrëveshjeve dhe licence marrëveshjeve.
- Specialistët e Drejtorisë së hidrokarbureve, kanë mesatarisht 17 vjet eksperiencë në punë, por si rezultat i lëvizjeve të shpeshta përvoja në AKBN është mesatarisht 4.5 vjet, në një kohë që marrëveshja hidrokarbure për vendburimin e Patos Marinzës ka mbi 12 vjet që nga nënshkrimi, duke shfaqur mungesë qëndrueshmërie në punonjësit e kësaj fushe dhe për pasojë reflekton drejtpërdrejtë në cilësinë dhe shkallën e zbatimit të të drejtave që lindin nga marrëveshjet hidrokarbure.
- Në Sektorin e monitorimit të investimeve nuk ka ekonomistë dhe i tillë është në sektorin e licencave ose nuk ka inxhinier në sektorin e monitorimit të marrëveshjeve. Pra krahas, mungesës së përvojës në AKBN, konstatohet se nuk ka një kombinim të arsyeshëm të profesioneve brenda sektorëve, në funksion të detyrave dhe të drejtave sipas marrëveshjeve hidrokarbure.
- Nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të AKBN nuk kanë trajtim prioritar juridik marrëveshjet dhe licencë marrëveshjet në fushën e hidrokarbureve, si dhe i mungon ekspertiza e specializuar e kësaj fushe, duke e bërë akoma më të vakët ndikimin pozitiv të juristëve në zbatimin me korrektësi të marrëveshjeve hidrokarbure, kjo për mungesë edhe të kurseve dhe trajnimeve të specializuara.
- Specialistët e Drejtorisë së hidrokarbureve nuk kanë qenë në gjendje të japin tregues të matshëm të veprimtarisë së tyre, për më tepër, që evidentojnë problem kryesor të marrëveshjeve hidrokarbure, zbatimin me korrektësi të tyre, duke demonstruar se nuk e shikojnë veten përgjegjës dhe të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e tyre.
- Specialistët e Sektorit të marrëveshjeve hidrokarbure e konsiderojnë veten të limituar në zbatimin e licencave apo marrëveshjeve hidrokarbure që operojnë vetëm në kërkimin dhe zbulimin e hidrokarbureve, gjë që nuk përputhet me përshkrimin e punës (lidhja nr. 1 e Rregullores së brendshme), si dhe kjo tregon se midis sektorëve brenda Drejtorisë së hidrokarbureve, nuk është vepruar sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme lidhur me marrëveshjet hidrokarbure në fazë prodhimi, duke mos ndikuar në arritjen e rezultateve gjatë zbatimit të marrëveshjeve, aq më tepër për të evidentuar përgjegjësitë lidhur me performancën individuale dhe sektoriale.
- Sektori i monitorimit të investimeve, ndonëse me përvojën më të paktë në AKBN (afër 3 vjet), me një nga aktivitetet më të rëndësishme nga i cili varet kostoja e prodhimit dhe realizimi i tij, në vitin 2015 kanë monitoruar investimet në terren për marrëveshjet në fazë prodhimi vetëm mesatarisht 2 herë, duke shprehur mungesën e trajtimit prioritar nga ana e AKBN të marrëveshjeve të prodhimit, përgjegjësi të limituar nga monitoruesit kur nuk ju rezultojnë problematika, performancë e vakët e sektorit për të cilin është ngritur.
- Mungesa e organizimit të sektorëve dhe specialistë të veçantë brenda tyre ose në kuadër institucional të AKBN mbi të dhënat për statistikën ekonomike dhe financiare sipas secilës marrëveshje, vështirëson ndjeshëm shqyrtimin e ecurisë së tyre jo vetëm nga institucionet e auditimit të jashtëm (KLSH) por edhe vetë të AKBN, për të propozuar përmirësime të shfrytëzimit të pasurive nëntokësore në dobi të shtetit dhe shtetasve shqiptar.

Për këto rekomandojmë:

8. AKBN të bëjë rishikim të strukturës organike për Drejtorinë, sektorët, numrin dhe llojet e specialistëve brenda tyre, mbi bazën e një analize të hollësishme të performancës së deritanishme, duke filluar në nivel individual, si dhe përshtatja e harmonizimi i tyre me detyrat institucionale të saj dhe kërkesave të LM dhe M, nëpërmjet edhe shkurtimit të sektorit të promovimit dhe fuqizimit të sektorëve kyç në veprimtarinë hidrokarbure.

Brenda muajit Janar 2017

9. AKBN të sigurojë qëndrueshmëri të specialistëve të ngarkuar me detyra në fushën hidrokarbureve, duke rishikuar, përmirësuar dhe saktësuar detyrat e tyre në përshkrimin e punës në drejtim të vendosjes së treguesve të matshëm dhe të kryhet vlerësimi periodik 6 mujor, në funksion të zbatimit korrekt të marrëveshjeve hidrokarbure.

Brenda muajit Janar 2017

10. Për shkak të ndërthurjes së veprimtarisë hidrokarbure me kompaninë publike kombëtare të hidrokarbureve, AKBN të vendosë në Rregulloren e brendshme të saj shkëmbimin e informacionit dhe problematikës me Albpetrol ShA, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe eficiencës së marrëveshjeve hidrokarbure në Shqipëri.

Menjëherë

11. AKBN të trajtojë me prioritet inspektimet, monitorimet, kontrollet supervizimet teknike dhe mjedisore në terren të marrëveshjeve hidrokarbure në përgjithësi dhe atyre në fazë prodhimi në veçanti, që të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe të kryhen në kohën e ndodhjes tyre.

Vazhdimisht

12. AKBN të marrë masat e duhura për të organizuar dhe mbajtur në mënyrë të vazhdueshme të dhënat për statistikën ekonomike dhe financiare sipas secilës marrëveshje hidrokarbure, në format elektronik dhe shkresor brenda drejtorisë përkatëse, si dhe të mbyllë ciklin e plotë të kërimit, zbulimit, zhvillimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit brenda saj, për të gjitha të drejtat që lindin mbi bazën e LM dhe M.

Brenda muajit Janar 2017 dhe Vazhdimisht

IV. Për pyetjen: A ka ndikuar veprimtaria monitoruese e AKBN në marrëveshjet hidrokarbure të prodhimit?

a) Në lidhje me planet e zhvillimit:

- Planet e zhvillimit (viti 2006 dhe 2009) janë paraqitur dhe miratuar si projekte me disa skenarë, sipas të cilëve do të kryhen operacionet hidrokarbure nga kontraktori në vendburimin e Patos-Marinzës dhe se përfitueshmëria ekonomike nga këto aktivitete do të jetë në varësi të probabilitetit se cili nga këto skenarë do të përdoret në kohë të ndryshme dhe në situata të ndryshme. Në të njëjtën kohë përfitueshmëria për shtetin shqiptar varet nga vlera e koeficientit R, i llogaritur sipas një formule të përcaktuar në MH. Kjo përfitueshmëri për kontraktorin është parashikuar duke përdorur formula dhe funksione financiare (NPV dhe IRR) ku edhe për parashikim e vlerave të tyre, janë përdorur variabla të ndryshëm në lidhje me kthimin nga investimi, koston e kapitalit, kohën e implementimit etj., por në asnjë rast nuk evidentohet analiza duke dhënë vlera për koeficientin R.

- Diferencat në lidhje me vlerat e parashikimeve për shpenzimet kapitale dhe ato operacionale, teknologjitë dhe metodat e përdorura për përcaktimin e prodhimit dhe sasive të ndryshme sipas rasteve dhe mundësive të ngjarjes, janë të konsiderueshme. Për më tepër dhe më kryesorja është se kontraktori shprehet se parashikimet e prodhimit dhe ato fiskale nuk janë garanci për fitim për Albpetrolin dhe Qeverinë Shqiptare, AKBN apo dhe vetë kontraktorin, dhe se devijimet nga këto parashikime nuk përbëjnë mospërputhje me MH, Planin e zhvillimit apo LMH.

- Në të njëjtën kohë në MH dhe LMH është përcaktuar se mbulimi i plotë i kostove hidrokarbure do të bëhet nga të ardhurat e shitjes së naftës së disponueshme, d.m.th prodhuar duke i bërë këto plane zhvillimi dhe përfitueshmërinë ekonomike shumë të ndjeshme dhe të varur totalisht tek kostot e investimit dhe shpenzimit. Nga AKBN dhe Albpetrolin nuk është analizuar dhe shqyrtuar me vëmendjen e duhur plani i zhvillimit për të kërkuar dhe saktësuar se kur $R \geq 1$ dhe siguruar përfitueshmërinë ekonomike për shtetin shqiptar.

Për këtë rekomandojmë:

13. MEI dhe AKBN të marrin në analizë situatën e deritanishme, dhe pas nxjerrjes së përgjegjësive të japin rekomandimet e duhura dhe konkrete për zgjidhjen e ngërçit të krijuar në lidhje me realizimin e faktorit $R > 1$, në afate të mirëpërcaktuara, duke siguruar nëse do të jetë e mundur përfitueshmërinë ekonomike të shtetit shqiptar nga kjo Marrëveshje Hidrokarbure.

Brenda tremujorit të parë 2017

14. Në rast se do të ketë amendime të tjera të Planit të Zhvillimit, AKBN të marrë masat që të analizojë në mënyrë të detajuar dhe me kompetencën e duhur profesionale këto plane, dhe të kërkojë paraqitjen në to të të dhënave të sakta dhe jo të hamendësuar dhe hipotetike.

b) Në lidhje me Programet e punës vjetore dhe Buxhetet përkatëse:

- Miratimi i planeve vjetore të punës dhe buxheteve përkatëse (2011-2016) është shoqëruar me një problematikë të theksuar në lidhje me respektimin e afateve sipas përcaktimit në LMH dhe MH si dhe referuar përmbajtjeve të tyre. Në këto plane, gjatë shqyrtimit, analizimit dhe aprovimit të tyre nga Albpetroli me anë të përfaqësuesve të saj në Komitetin Këshillimor (KK) dhe më pas nga AKBN për t'i miratuar ato, janë evidentuar problematika në lidhje me paraqitjen e aktiviteteve që do të kryhen nga kontaktori për prodhimin dhe teknologjinë, mos arritjen e sasive të planifikuara në vitin paraardhës, dhe për pasojë mos arritjen e faktorit $R > 1$ për vitin 2013, diferenca në përdorimin e holluesit ku vlera është 67 milion \$, puse të rinj jo aktiv, rritje të shpenzimeve, ndryshime të sasisë së prodhuar (viti 2012) etj. Kjo të çon në dyshimin e arsyeshëm se janë pranuar dhe miratuar në heshtje këto problematika kur sipas LMH dhe MH, së paku duheshin çuar çështjet tek eksperti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas afateve të caktuara.

- Ndryshimet e shumta në të njëjtin plan dhe për të njëjtin vit fiskal (2013), si dhe aprovimi në KK vetëm nga përfaqësuesit e kontraktorit kjo në kundërshtim me MH, dhe miratimi i tij nga ana e AKBN pa një analizë të thelluar të çështjes dhe kundërshtimin me forcë, duke u fokusuar tek ndryshimet në planet e paraqitura dhe ndikimin e tyre tek faktori R, kanë patur ndikim negativ tek përfitueshmëria ekonomike e shtetit shqiptar gjatë zbatimit të këtyre planeve dhe operacioneve hidrokarbure për vitin fiskal përkatës.

-Moszgjidhja e pa dakordësive dhe mosmarrëveshjeve midis palëve dhe zgjatja e tyre me komunikime dhe njoftime ndaj njëri tjetrit, ka bërë që planet vjetore të konsiderohen si të miratuara nga kontaktori dhe kur nuk ka patur dakordësinë e Albpetrolit dhe AKBN nuk i ka miratuar paraprakisht ato, në një kohë kur janë tejkaluar deri në 1 vit afatet (2014 - 2015) dhe tashmë ato janë vënë në zbatim nga kontraktori ashtu siç i ka gjykuar dhe zbatuar ai vetë. Në periudhën 2013 - 2015 kontraktori ishte angazhuar që $R > 1$. Plani i vitit 2016 nuk është i miratuar akoma.

Për këtë rekomandojmë:

15. AKBN të marrë masa për të zgjidhur çështjet e mbetura pezull në lidhje me programet e punës dhe buxhetet përkatëse të viteve 2014, 2015 dhe 2016, edhe pse ato janë tashmë faktike, si dhe të evidentojë ato vlera shpenzimesh që janë në kundërshtim me LMH, MH, Planin e Zhvillimit të miratuar, duke i kategorizuar shpenzime të panjohura dhe si kosto të parikuperueshme, dhe t'i llogarisë me zbritje duke rishikuar vlerën e faktorit R, sipas periudhave përkatëse.

Brenda tremujorit të parë 2017

16. AKBN të analizojë dhe veprojë sipas të drejtave që i linden nga përcaktimet e MH dhe LMH në lidhje me miratimin e programit të punës dhe buxhetit për vitin 2017 dhe në vazhdim, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore që nga eksperti, arbitrazhi dhe deri tek prishja e marrëveshjes në rast të evidentimit dhe përsëritjes së parregullsive të mësipërme në këtë procedurë.

Brenda muajit dhjetor 2016

c) Monitorimet e kryera nga AKBN për vendburimin e Patos-Marinëz.

- Cilësia dhe përmbajtja e monitorimeve dhe inspektimeve të vëna në dispozicion, lënë shumë për të dëshiruar. Nuk është bërë analizë e periudhave tre-mujore që kontraktori paraqet në AKBN, si për periudhën paraardhëse ashtu dhe atë pasardhëse në lidhje me të gjithë operacionet që do të kryejë në zonën e kontratës. Nuk janë evidentuar mangësitë dhe parregullsitë brenda një periudhe relativisht të shkurtër dhe brenda të njëjtit vit fiskal, duke krahasuar planin e paraqitur me faktin për të nxjerrë të në pah shmangiet dhe më pas të kontestoheshin sipas të drejtave të LMH dhe MH, të evidentuara këto në PP&B.

- Evidentimi i problemeve por mos dhënia zgjidhje ose mos ndjekja e tyre më tej, ka ndikuar negativisht në zgjidhjen e tyre dhe duke favorizuar kontraktorin dhe jo shtetin shqiptar. Për më tepër DH nuk i ka kryer dhe kryen monitorimet në bazë të plani të menaxhimit të riskut apo më thjesht duke i drejtuar ato në ato zona apo operacione ku rastet e parregullsive apo të shmangiet nga planet do të ishin më e të mundshme.

- DH dhe AKBN nuk ka bërë një analizë të përditësuar, në vazhdimësi dhe të saktë në lidhje me operacionet hidrokarbure të kryera nga kontraktori, kjo u konstatua dhe nga mungesa e plotësisht të dhënave të kërkuar nga grupi i auditimit sipas aneksit..., të këtij Raporti, ku mund të përmendim të dhëna për prodhimin, shpenzimet kapitale dhe operative, të ardhurat etj., duke i krahasuar plan fakt.
- Në rastin e vitit 2013 ku nga monitorimet është evidentuar rritje e prodhimit më shumë se plani, ulje të shpenzimeve për shpimin e puseve të rinj në lidhje me planin, që zënë peshën më të madhe të investimeve për periudhën, duke futur dhe fillimin e 2014 për monitorimin e fundvitit 2013, nuk kuptohet arsyeja se përse nuk është vazhduar më tej me evidentimin, pasqyrimin dhe analizimin e kësaj situatë. Nuk u vu në dispozicion dokument justifikues shkresor në lidhje me komunikimin e DH me Ekzekutivin e AKBN për këtë situatë. Kjo është një nga çështjet më të rëndësishme pasi në këtë rast do të kishim një vlerë të pastër të $R > 1$ duke derivuar fitim për shtetin shqiptar. Ky veprim ka shkaktuar efekt financiar negativ për shtetin shqiptar, por nuk mund të shprehemi me vlera të sakta monetare të këtij fitimi të munguar.
- AKBN si përfaqësuese e shtetit shqiptar dhe të drejtave të LMH¹ nuk ka analizuar rezultatet e monitorimeve për të dalë me konkluzioneve dhe vendime konkrete pasi situata në vazhdim ka sjellë plane vjetore dhe buxhete përkatëse pasardhëse të kontestuara kryesisht në mbledhjet e KK nga përfaqësuesit e Albpetrolit, dhe më pas të pa miratuara. Këto janë marrë të mirëqena të miratuara nga kontraktori ashtu siç i ka paraqitur ai dhe duke i ndryshuar herë pas here, me pretendimin e tejkalimit të afateve.
- Për sa më lart mbajnë përgjegjësi drejtori i DH për mënyrën e pa efektshme të drejtimit të drejtorisë dhe miratimit të monitorimeve që nuk kanë përmbajtjen e një dokumentacioni monitorues apo inspektues etj, mungesën e koordinimit me Drejtorin Ekzekutiv të AKBN për gjetjen e zgjidhjes së problematikave si dhe drejtori Ekzekutiv i AKBN, për mos marrjen e masave konkrete dhe detyruese për kontraktorin në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i LMH dhe MH.

Për këtë rekomandojmë:

17. MEI dhe AKBN të marrë masa për analizimin e situatës në lidhje me rastet evidentuara me problematikë në monitorimet e deritanishme duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, dhe duke rekomanduar masa konkrete për zgjidhjen e situatave, si dhe të hartojnë dhe miratojnë procedurë dhe/ose rregullore në lidhje me monitorimet, inspektimet, kontrollet që duhet të kryhen për operacionet hidrokarbure.

Brenda tremujorit të parë 2017

18. AKBN bazuar në të drejtat që i linden nga LMH dhe MH t'i kërkojë kontraktorit rregullimin e procedurave apo proceseve të evidentuara si problematike, si dhe në rastet e evidentimit të parregullsisë apo shkeljeve të MH dhe LMH nga ana e kontraktorit, t'i drejtohet në kohën e duhur sipas përcaktimit në LMH dhe MH tek eksperti, arbitrazhi, deri edhe për prishjen e marrëveshjes.

Në vazhdimësi

19. AKBN të marrë masa për vënien para përgjegjësive të stafit të saj në rastet e mos përmbushjes së detyrave në lidhje me ndjekjen dhe monitorimin e marrëveshjeve hidrokarbure në kuadër të arritjes së përfitueshmërisë ekonomike nga to të shtetit shqiptar, qofshin dhe staf apo anëtarë të menaxhimit të lartë drejtues.

Brenda tremujorit të parë 2017

20. AKBN dhe DH të marrin masa për të bërë një analizë të plotë dhe të detajuar, duke u bazuar në një ekspertizë profesionale dhe me integritet, në lidhje me evidentimin e saktë të ecurisë së deritanishme të MH për vendburimin e Patos-Marinzës, në lidhje me prodhimin, shpenzimet të ardhurat si faktorë kyç që lidhen me faktorin R, por pa lënë më një anë edhe aspektet dhe operacionet e tjera hidrokarbure.

Brenda tremujorit të parë 2017

21. Drejtorja e DH në AKBN, të hartojë plane pune sipas një analize risku për evidentimin e operacioneve më të prekshme të prirura ndaj shmangieve dhe devijimit nga planet

¹ Neni 6.4 i LMH.

apo të ku mund të ketë fushë për abuzim dhe mashtrimi duke fryrë kostot hidrokarbure, duke i orientuar dhe drejtuar monitorimeve dhe inspektimeve sipas çështjeve të mirëpërcaktuara.

Vazhdimisht

V. Për pyetjen: A ka qenë efektiv aktiviteti auditues i AKBN në marrëveshjet hidrokarbure të prodhimit?

- Auditimi nga AKBN ka filluar për vitin 2006, duke mos ushtruar të drejtën e saj pasi për rreth 2 vite aktivitet hidrokarbur të marrëveshjes, i ka hequr mundësinë përfaqësuesit shtetëror për kundërshtimin kostove hidrokarbure të përfshira në të rikuperueshme ose jo.
- Gjatë auditimeve të kryera, AKBN ka shfaqur mungesë kompetence dhe profesionalizmi si nga ana e specialistëve të saj, ashtu edhe duke angazhuar ekspertë kontabël ose kompani audituese të pavarura, kryesisht në vitet e fillimit të marrëveshjes.
- Për më shumë se 10 vjet AKBN ka kryer auditime të përcipta dhe pothuajse formale për marrëveshjen me B (që përkon me vitin 2011 të aktivitetit të saj), bazuar në çështjet e audituara, auditimin e aktivitetit të dy viteve financiar së bashku apo të dy marrëveshjeve, gjetjet e deriatëhershme dhe ato të vitit 2011, kohëzgjatjen e auditimit dhe evadimit të tij, vlerat dhe parregullsitë, indiferencën e AKBN në mos batimin e rekomandimeve të saja etj., duke e kthyer në një veprimtari rutinë të saj, thjeshtë dhe vetëm në certifikimin e kostove të rikuperueshme hidrokarbure të kontraktit B.
- Auditimet e AKBN nuk janë të mbështetura dhe në praktikat ndërkombëtare të fushave të tilla audituese, pasi nuk janë shprehur në se Kontraktori ka kryer kënaqshëm detyrimet operationale, tregtare, financiare, të tatimeve dhe taksave si dhe atë raportuese, sipas përcaktimeve në marrëveshje; Kontraktori ka mbajtur regjistra të përshtatshëm të llogarisë në përputhje me termat dhe kushtet e marrëveshjes etj.
- AKBN nuk ka komunikuar zyrtarisht me Albpetrol ShA në lidhje me gjetjet: cilësinë, llojet dhe vlerën e tyre, me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë audituese, në interes të rritjes së përfitueshmërisë nga marrëveshjet hidrokarbure.
- AKBN i ka konsideruar auditimet si tekniko-financiare, çka do të thotë se kontrollet, supervizimet, inspektimet, monitorimet teknike të cilat në kuptimin e marrëveshjes dhe licencë marrëveshjes kanë karakter të vazhdueshëm dhe duhet të kryhen në kohë reale, janë realizuar edhe tre vjet pas ndodhjes së tyre dhe në mënyrë sporadike.
- Megjithëse që në vitin 2010 (për aktivitetin e vitit 2008-2009) në auditim ka rezultuar se, nga ana e kontraktorit janë deklaruar më pak të ardhura për te dy vitet së bashku në vlerën 3,195,000 USD, nuk ka shërbyer si një sinjal shumë i rëndësishëm për AKBN për të vlerësuar, inspektuar, mbikëqyrur dhe kontrolluar secilin prej raportimeve kontabël në vijim.
- Në auditimin e vitit 2013, AKBN ka vërejtur se nuk janë zbatuar rekomandimet e auditimit 2008-2009 për zbritjen nga kostot e rikuperueshme të shumave të përcaktuara në auditim, por nuk ka vepruar më tej për të kërkuar zgjidhjen miqësore të këtyre mosmarrëveshjeve.
- Në auditimin tekniko-financiar i vitit 2011 është kryer nga AKBN në mars të vitit 2014, konstatohet se kontraktori nuk ju ka vene ne dispozicion dokumente për auditim si kontrata, dokumente për asetet fikse, mungesë disponibiliteti etj., veprime të cilat janë në kundërshtim me LMH dhe janë konstatuar një sërë parregullsish me kosto të parikuperueshme 247,397,666 USD. Kjo shumë e konsiderueshme është dërguar nga ana e B për shqyrtim nga ekspertët e pavarur, të cilët kanë vendosur për t'i përfshirë në kostot hidrokarbure, për shkak se pavarësisht shkeljeve, “palët nuk ofruan prova bindëse për të sugjeruar se kostot qenë të paarsyeshme”, duke ia ngarkuar në këtë mënyrë përgjegjësinë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe paaftësisë së kësaj agjencie për të monitoruar dhe identifikuar shkeljet në kontratën më të madhe koncesionare të Shqipërisë aktualisht.
- Edhe në auditimin e AKBN të vitit 2012 (të kryer në 2014), vazhdojnë të njëjtat problematika dhe vlera e gjetur e kostove të konsideruar të parikuperueshme, do të bënte që faktori R të ishte më i madh se sa 1, duke u rritur fitimi për shtetin shqiptar dhe përqindja e prodhimit të marrë nga Albpetrol ShA.

Për këto rekomandojmë:

22. **AKBN të marrë masat e nevojshme për trajnimin e specialistëve që angazhohen në auditimin e marrëveshjeve hidrokarbure, me qëllim njohjen në detaje të secilës marrëveshje në veçanti dhe kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të LM e Marrëveshjes hidrokarbure dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.**

Brenda tremujorit të parë 2017

23. **AKBN të kryejë auditime të mirëfillta sipas përcaktimeve në licencë marrëveshje dhe në marrëveshje, duke i ndarë nga inspektimet teknike, për të bërë të mundur një auditim më operativ menjëherë pas dorëzimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, si dhe kryerjen e vazhdueshme të inspektimeve, monitorimeve, mbikëqyrjeve dhe kontroleve teknike në kohën e ndodhjes tyre.**

Në vazhdimësi

24. **AKBN të komunikojë zyrtarisht me kompaninë publike të hidrokarbureve (Albpetrol ShA) në lidhje me gjetjet e auditimit: cilësinë, llojet dhe vlerën e tyre, me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë audituese, në interes të rritjes së përfitueshmërisë nga marrëveshjet hidrokarbure në vendin tonë.**

Në vazhdimësi

25. **AKBN të zbatojë rrugët ligjore sipas përcaktimeve në LM dhe M për vlerat e gjetura deri tani nga auditimet dhe të rezultuara në kosto hidrokarbure të parikuperueshme, të mbështetura në dokumentacionin argumentues ligjor dhe zyrtar, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, MEI-n dhe Ministrinë e Financave.**

Menjëherë

26. **AKBN gjatë auditimeve të marrëveshjeve hidrokarbure, të zënë vend të rëndësishëm çështjet sipas praktikave ndërkombëtare: Kontraktori ka kryer ose jo kënaqshëm detyrimet operacionale, tregtare, financiare, të tatimeve dhe taksave si dhe atë raportuese, sipas përcaktimeve në marrëveshje; Të gjitha shpenzimet për kostot e rikuperueshme, siç janë raportuar, kanë plotësuar ose jo të gjitha kërkesat dhe kushtet të cilësohen si shpenzime të lejueshme të kostove të rikuperueshme, dhe vlerat e deklaruar janë mbështetur ose jo nga një evidence e përshtatshme, kompetente, të auditueshme dhe praktike etj.**

Vazhdimisht

VI. Për pyetjen: A ka qenë i dobishëm monitorimi dhe inspektimi nga Albpetrol ShA i marrëveshjeve hidrokarbure të prodhimit?

- Veprimtarinë monitoruese dhe problematikat e ngritura në këto monitorime dhe inspektime nga ana e Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure (DMH) në Albpetrol ShA është shumë e pakët duke e lidhur me aktivitetin e gjatë të operacioneve të kryera në vendburimin e Patos-Marinzës, sipas MH. Këto monitorime i përkasin vetëm dy viteve të fundit, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion. Edhe në këtë periudhë (2014-2016) nuk është bërë ajo që duhet në lidhje me monitorimin e operacioneve hidrokarbure duke parë ecurinë e dobët të kësaj marrëveshje, ku Albpetroli ka marrë vetëm 1% të tij.

- Nga ana e DMH dhe Albpetrolit janë evidentuar problematika në lidhje me prodhimin e naftës, gjatë monitorimit në vitin 2015 pas testeve të kryera një numër të konsiderueshëm pusesh (mbi 50) dhe është paraqitur rezultati i këtij testimi në formë grafiku dhe analize teknike tabelore, pa një raport të shkruar dhe të qartë të detajuar me një analizë ku të evidentohen vlerat konkrete të diferencave dhe shmangie të prodhimit të raportuar nga kontraktori, pasi kjo përbën një rast ku mund të dal në pah dorëzimi i deklaratave të pasakta nga ana e kontraktorit.

- Në mbledhjet e KK përfaqësuesit e Albpetrolit kanë paraqitur mos dakordësinë e tyre në lidhje me përdorimin e holluesit (viti 2013), si dhe mjaft problematika të tjera që kanë pasuar në lidhje me prodhimin, shpenzimet të ardhurat etj. DMH dhe Albpetroli nuk kanë qenë të fokusuar dhe predispozuar në lidhje me proçeduarit e monitorimit, kontrollit dhe inspektimit, përgjatë kohës së fillimit të kryerjes së operacioneve hidrokarbure në këtë vendburim dhe deri më sot.

- Nga ana DMH nuk është e bërë analizimi i Programeve vjetore dhe Buxheteve dhe krahasimi i të dhënave të raportuara dhe realizuar plan-fakt, duke e evidentuar këtë proçedurë dokumentacionin

përkatës. Po ashtu dhe në lidhje me Q-të përkatëse ku vetëm në një numër të papërfillshëm rastesh (5), të analizuar të veçuar dhe sporadikë në 2016 dhe të dokumentuar kanë rezultuar mjaft probleme të rëndësishme dhe me ndikim kryesor tek prodhim dhe faktori R. Kjo të çon në hamendësimin e arsyeshem, duke ju referuar rrjedhës së ngjarjeve, që edhe në periudhat e mëparshme (2016 e para) kanë ekzistuar të tilla probleme por nuk janë evidentuar dhe dokumentuar. Për sa më lart mban përgjegjësi Drejtori i DMH dhe Administratori i Albpetrol Sh.a, sipas periudha përkatëse.

Për këtë rekomandojmë:

27. Albpetroli dhe DMH të marrë masa për të evidentuar të gjitha mospërputhjet si në vlera dhe në sasi në lidhje me shifrat e raportuar nga kontraktori, duke mundësuar dokumentimin e këtyre mospërputhjeve.

Brenda muajit janar 2017

28. Albpetroli dhe DMH të marrë për të rritur numrin dhe cilësinë e inspektimeve, monitorimeve dhe kontroleve në fushat që paraqesin riskun më të lartë, duke i evidentuar këto fusha që në diskutimet paraprake për miratimin e planeve vjetore dhe kushteve përkatëse.

Vazhdimisht

29. Albpetroli të ndjekë me rigorozitet zbatimin e PP&B, gjatë zbatimit duke evidentuar, dokumentuar dhe kontestuar, sipas të drejtave që i linden nga MH, mosrakordimet dhe devijimet e fakti nga plani, në kohën kur ato ndodhin, me qëllim rritjen e përfitimeve nga marrëveshjet e hidrokarbureve.

Vazhdimisht

30. Albpetroli dhe DMH të ketë në fokus dhe si prioritet analizimin e tremujorëve përkatës të dërguar nga kontraktori si në plan ashtu dhe fakt duke evidentuar, dokumentuar dhe duke kërkuar zgjidhjen e mos-rakordimeve që në momentin e duhur.

Vazhdimisht

31. Albpetroli dhe AKBN të intensifikojë dhe rrisë veprimtarinë monitoruese dhe kontrollues në terren në lidhje me aktivitetin e prodhimit, shpimit të puseve si dhe të aktivitet e shërbimeve duke u fokusuar në këto të fundit në saktësimin e kostove sipas zërave përkatës.

Vazhdimisht

VII. Për pyetjen: A kanë ndikuar auditimet e Albpetrol ShA në rritjen e përfitueshmërisë nga marrëveshjet?

- Albpetrol ShA ka kryer auditimin e marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Patos - Marinzë (B) nëpërmjet Auditit të brendshëm deri në prill të vitit 2015, dhe më pas është krijuar Sektori i auditit të brendshëm në Drejtorinë e hidrokarbureve, në strukturë të përbërë nga 3 punonjës, por që aktualisht rezulton me 2 auditues.

- Në të gjitha rastet periudha e auditimit nuk përfshin vite të plota fiskale, por tremujore të ndryshëm midis viteve fiskale, të cilët e kalojnë këtë periudhë kohore, gjë e cila nuk është në përputhje me afatet e vendosura në marrëveshje dhe shkakton vështirësi në koordinimin dhe bashkëpunimin e kësaj procedure me AKBN.

- Në asnjë rast Albpetrol, nuk ka ushtruar të drejtën e tij për të kryer deri në dy auditime për çdo vit fiskal, duke mos e konsideruar këtë mundësi si një nga çështjet më të rëndësishme të marrëveshjeve hidrokarbure, e lidhur me përfitueshmërinë prej tyre.

- Sipas përcaktimeve në marrëveshje, Albpetrolit i lind e drejta e auditimit të librave të llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive jo më shumë se dy herë në një vit fiskal, çka do të thotë se deri tani duhej të ushtronte së paku 11 auditime, në fakt ka kryer 7 auditime (evaduar janë 6), gjë që tregon se nuk i është dhënë vëmendja e duhur këtij procesi.

- Deri në vitin 2013, auditimet e kryera nga Albpetrol ShA kanë qenë të përcipta, të varfër në përmbajtje, pa gjetje thelbësore, me çështje të auditimit që nuk përfshijnë të gjithë problematikën mbi librat e llogarisë në se janë në përputhje me procedurën llogaritëse, transaksionet e tjera të kryera në lidhje me Operacionet hidrokarbure, kostot dhe shpenzimet e mbartura dhe të kryera nga kontraktori

në ose në lidhje me operacionet hidrokarbure në përputhje me marrëveshjen etj., gjë që tregon për mungesë të kapaciteteve audituese dhe mungesë përgjegjësi nga ana e Albpetrol ShA në këtë drejtim.

- Edhe në rastet e konstatimit të ndonjë problematike, grupet e auditimit nuk kanë rekomanduar (ngritur objeksione) mbi dokumentacionin e librave, regjistrimeve dhe llogarive, duke e kthyer këtë në një proces formal dhe pas asnjë lloj efekti pozitiv në zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure të prodhimit për vendburimin e Patos-Marinzës.

Për këtë rekomandojmë:

32. Albpetrol ShA të marrë masat nevojshme për plotësimin e me një auditues të sektorit të hidrokarbureve për të siguruar numrin e nevojshëm dhe cilësinë e duhur të marrëveshjeve hidrokarbure, me prioritet ato të prodhimit.

Brenda muajit janar 2017

33. Albpetrol ShA të bëjë të mundur auditimin e plotë, me prioritet dhe synim dy herë të vitit të plotë fiskal, si një nga çështjet më të rëndësishme të marrëveshjeve hidrokarbure, e lidhur me përfitueshmërinë prej tyre.

Vazhdimisht

34. Albpetrol ShA të kryejë auditime të plota, duke përfshirë të gjithë problematikën mbi librat e llogarisë në se janë në përputhje me procedurën llogaritëse, transaksionet e tjera të kryera në lidhje me Operacionet hidrokarbure, kostot dhe shpenzimet e mbartura dhe të kryera nga kontraktori në ose në lidhje me operacionet hidrokarbure në përputhje me marrëveshjen etj., duke rekomanduar (ngritur objeksione) mbi këto çështje, për të ndikuar në rritjen e përfitueshmërisë nga zbatimi i marrëveshjeve hidrokarbure të prodhimit.

Vazhdimisht

VIII. Për pyetjen: A kanë qenë efektiv inspektimet dhe monitorimet mjedisore të marrëveshjeve të prodhimit?

a) Monitorimet e AKBN për mjedisin.

- Nga ana e DH në AKBN në lidhje me monitorimet për çështjet mjedisore, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet është bërë një numër shumë i vogël i tyre, dhe këto shumica në vitin 2015. Edhe monitorimi i bërë në nëntor të 2014 pas shqetësimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, nuk ka identifikuar asnjë problematikë, kur në dokumentin e publikuar nga komiteti renditen një sërë shqetësimesh.

- Duke bërë përjashtim rastin e fontanimit, dhe kjo për shkak të vëmendjes së madhe të krijuar, por edhe për këtë rast mund të shprehemi me rezervave. Një herë nënkontraktori cilësohet si i pa aftë teknikisht dhe se nuk ka zbatuar rregullat dhe masat mbrojtëse të duhura dhe pas disa ditëve nuk përmendet fare. Akoma më keq kur në një monitorim me tematikë tjetër por edhe ky në lidhje me sigurinë, AKBN shprehet se çdo gjë është në rregull, bile edhe vlerësime me pozitivitet lartë kundrejt tij.

- Referuar dokumentacionit, DH në AKBN nuk e ka prioritet monitorimin në lidhje me çështjet mjedisore të këtij vendburimi. Edhe këto monitorimi të bëra në 2015 duket sikur janë bërë sa për të kaluar radhën dhe jo për të evidentuar dhe nxjerrë përgjegjësitë kontraktorin, pasi ai është i vetmi që kryen operacione në këtë zonë.

- Raportimi i monitorimeve kur njëherë citohet dokumentacioni i kërkuar, pastaj thuhet se kontraktori e ka dokumentacionin, dhe në fund lihen rekomandime që të pajiset me këtë dokumentacion nuk janë serioze. Për sa më lart mban përgjegjësi DH dhe Drejtori Ekzekutiv sipas periudhave, duke theksuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ngrehet hamendësimi i arsyeshëm se ndaj kontraktorit, për periudhën e mëparshme (2014 e para), nuk i është bërë asnjë kontroll në lidhje me çështjet e mjedisit.

b) Monitorimet e Albpetrolit për mjedisin.

- Monitorimet e paraqitura nga Albpetrolit, duke përmendur atë të fontanimit dhe atë të ndotjes së sheshit tjetër, si më me rëndësi nga ato të paraqitura në mjedisin, duket më tepër sikur janë korrespondenca shkresore sesa monitorime. Nga ana tjetër zgjatja e këtyre komunikimeve ku mund të theksojmë se në të dy rastet koha më e madhe është harxhuar duke i kthyer përgjigje dhe kundërshtime

njëri tjetrit sesa duke kërkuar zgjidhjen e çështje, e largon vëmendjen nga situata në zonën e ndotur pa marrë parasysh ndikimin e nivelit të ndotjes dhe rrezikun që mund të sjellë kjo zgjatje për zonën. Ky rrezik fillon që nga kërcënimi për jetën edhe shëndetin e njeriut dhe duke vazhduar tek dëmet e tokës, ujërave ajrit etj.

- Nga ana e Albpetrolit dhe DH në të, nuk janë parë me prioritet çështje e monitorimit dhe kontrollit në mjedis për vet faktin e numrit të monitorimeve të vënë në dispozicion, edhe pse ka një trend në rritje në lidhje me interesin për rritjen e numrit të monitorimeve, kjo situatë duhej të ishte kontrolluar që më parë dhe të paktën në ditët e sotme të mos përhapej më shumë.

- Në fillim-prillin e vitit 2015, gjatë veprimtarisë për nxjerrjen e naftës nga ana e B në territorin e fshatit Marinëz të Fierit ka ndodhur një shpërthim (fonatinim), i cili ka shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme banorëve të zonës, ndotje të ujërave, tokës bujqësore etj. Nga analiza e specialistëve të AKBN dhe Albpetrol-it është konstatuar se kjo ka ardhur si pasojë e veprimtarisë së nënkontraktorit për shpimet i kompanisë B P, nga mungesa e përgatitjes teknike dhe organizative për përballimin e rasteve të tilla gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure të kryera në pus.

Për këtë rekomandojmë:

35. AKBN e MEI, si dhe Albpetrol në bashkëpunimin dhe me institucionet e tjera të mjedisit, të monitorojnë më tepër kompanitë që kanë aktivitetin e tyre nxjerrjen e naftës nga nëntoka shqiptare, si në kuadër të pajisjes me dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit shqiptar për mjedisin ashtu dhe në anën operacionale.

Në vazhdimësi

36. Në rast të mos gjetjes së dakordësisë AKBN dhe/ose Albpetrol të çojë çështjen tek ekspertit ose arbitrazhi në kohën e duhur, aq më tepër në çështjet e lidhura me mjedis dhe sigurinë e jetës dhe shëndetit ku një zvarritje në kohë mund të ketë pasoja fatale.

Sipas rastit

37. AKBN dhe DH e saj, si dhe Albpetrol të marrë masa dhe të hartoj një plan të detajuar për monitorimin mjedisor të zonave përreth këtij vendburimi, duke u kryer nga specialistë përkatës të kualifikuar, për të evidentuar, raportuar, ndjekur dhe eliminuar parregullsitë që konstatohen.

Vazhdimisht

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R